

## Vaksinimi në vitet e para të jetës




### Fëmijët e imunizuar plotësisht

Imunizimi është një mjet i dëshmuar me kosto efektive për kontrollimin dhe eliminimin e sëmundjeve infektive të rrezikshme për jetën, dhe vlerësohet se parandalon prej 2 deri në 3 milionë vdekje çdo vit. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) rekomandon që të gjitha foshnjat dhe fëmijët e vegjël (sidomos ata nën moshën 2 vjeç) të vaksinohen kundër tuberkulozit, difterisë, tetanosit, kollës së keqe, poliomielitit, fruthit, hepatitit B, *haemophilus influenzae* e tipit B, sëmundjes pneumokokale, rotavirusit dhe rubeolës. Në Kosovë, **imunizimi themelor** i referohet fëmijëve të moshës 2 vjeç të vaksinuar kundër tuberkulozit, poliomielitit, difterisë, tetanosit, kollës së keqe dhe fruthit. **Imunizimi i plotë** i referohet fëmijëve të moshës 2 vjeç që kanë marrë të gjitha vaksinat e planifikuara për t'u marrë në dy vitet e para të jetës, sipas kalendarit kombëtar të imunizimit.

#### Imunizimi themelor


(BCG, IPV3, DTP3, dhe Fruthi 1)  
Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të kanë marrë të gjitha vaksinat themelore në çfarëdo kohë para anketës


#### Imunizimi i plotë

(BCG, OPV/IPVr, DTP, HepB2/HepB3\*, Hib3, Shytat, Rubeola dhe Fruthi 1)  
Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh që kanë marrë të gjitha vaksinat e planifikuara në dy vitet e para të jetës, sipas kalendarit kombëtar të imunizimit në çfarëdo kohë para anketës  
\*Mbulimi i plotë i imunizimit HepB përfshin fëmijët të vaksinuar sipas kalendarit të Kosovës me doza 0, 1, 2 dhe 3 dhe sipas kalendarit serb me doza 0, 1 dhe 2

#### Nuk janë imunizuar Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të cilet nuk kanë marrë asnjë vaksinë në çfarëdo kohë para anketës

Vaksina Bacillus Calmette-Guérin (BCG) mbron nga disa prej formave më vdekjeprurëse të tuberkulozit (TB), që është një infeksion bakterial. Vaksina e poliomielitit oral (OPV) dhe vaksina e poliomielitit joaktiv (IPV) sigurojnë mbrojtje kundër polios ose poliomielitit. Vaksina DTP është një vaksinë e kombinuar kundër tri sëmundjeve infektive: difterisë, tetanosit dhe kollës së keqe. Një rivaksinim DTP (DTP) është një administrim shtesë i vaksinës DT pas dozave primare. Vaksina HepB mbron kundër infeksionit të mëlçisë që shkaktohet nga virusi i hepatitit B. Vaksina Hib mbron nga bakteret *Haemophilus influenzae* të tipit B, një shkaktar kryesor i meningjitit tek fëmijët më të vegjël se 5 vjeç.


Informatat lidhur me mbulimin e vaksinimit në MICS mbledhen për të gjithë fëmijët nën moshën tre vjeç. Nënave ose kujdestarëve të fëmijëve nën moshën 36 muajsh u kërkohet të sigurojnë të dhënat rreth vaksinimit, domethënë kartela ose dokumente të ngjashme ku regjistrohen vaksinimet. Nëse të dhënat për vaksinimin e fëmijës janë në dispozicion, intervistuesit i kopjojnë informatat e vaksinimit nga kartelat e vaksinimit në pyetësorin MICS, dhe e pyesin të anketuarin për ndonjë vaksinë që nuk është e regjistruar në dokument. Nëse nuk ka të dhëna për vaksinimin e fëmijës, intervistuesi vazhdon të kërkojë nga nëna që të kujtohet nëse fëmija i saj ka marrë të gjitha vaksinat dhe, për antigjenet e aplikueshem, sa doza ka marrë fëmija. Informatat janë marrë edhe nga të regjistrat e vaksinimit në institucionet shëndetësore. Vlerësimet përfundimtare të mbulimit të vaksinimit bazohen në informatat e marra nga të dhënat e vaksinimit në institucionet shëndetësore, nga kartelat e vaksinimit në shtëpi ose nga raportimi i nënës për vaksinat që ka marrë fëmija. Për llogaritjen e treguesve të imunizimit, të dhënat nga institucionet shëndetësore përdoren si burimi i parë dhe më i besueshëm.

## Mesazhet kryesore

- 73 për qind e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh në Kosovë kanë marrë të gjitha vaksinat sipas kalendarit për imunizim në çfarëdo kohe para zhvillimit të anketës. Vetëm 38 për qind e fëmijëve që jetojnë në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë vaksinuar plotësisht.
- Gjendja ekonomike e ekonomisë familjare ndërlidhet pozitivisht me vaksinimin e plotë: 4 nga 5 fëmijët e moshës 24-35 muajsh që jetojnë në ekonomi familjare më të pasura në Kosovë janë të vaksinuar plotësisht, krahasuar me 3 nga 5 fëmijët që jetojnë në ekonomi familjare më të varfra. Një situatë e ngjashme vërehet edhe në mesin e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.


## Fëmijët e imunizuar plotësisht

**Imunizimi themelor**  
(BCG, IPV3, DTP3, dhe Fruthi 1)  
Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të kanë marrë të gjitha vaksinat themelore në çfarëdo kohë para anketës

**Nuk janë imunizuar**  
Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të cilet nuk kanë marrë asnjë vaksinë në çfarëdo kohë para anketës

**Imunizimi i plotë**  
(BCG, OPV/IPVr, DTPr, HepB2/HepB3\*, Hib3, Shytat, Rubeola dhe Fruthi 1)  
Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të cilët kanë marrë të gjitha vaksinat e planifikuara në dy vitet e para të jetës, sipas kalendarit kombëtar të imunizimit në çfarëdo kohë para anketës  
\*Mbulimi i plotë i imunizimit HepB përfshin fëmijë të vaksinuar sipas kalendarit të Kosovës me doza 0, 1, 2 dhe 3 dhe sipas kalendarit serb me doza 0, 1 dhe 2.

## Kalendarët e imunizimit


Kalendar i imunizimit për Kosovën i vitit 2018		Kalendar i imunizimit për fëmijët të cilët jetojnë në komunitetet serbe	
Mosha	Antigjeni/Doza	Mosha	Antigjeni/Doza
Në lindje	BCG	Në lindje	BCG
	Hepatitis B-0 (doza në lindje)		HepB-1 (doza e parë)*
Moshë 2 muajsh	Vaksina pentavalente: DTP-HepB-Hib-1 (doza e parë)	Moshë 1 muajsh	HepB-2 (doza e dytë)
	IPV-1 (doza e parë)	Moshë 2 muajsh	Vaksina pentavalente: DTP-IPV-Hib-1 (doza e parë)
Moshë 3 muajsh	Vaksina pentavalente: DTP-HepB-Hib-2 (doza e dytë)	Moshë 3.5 muajsh	Vaksina pentavalente: DTP-IPV-Hib-2 (doza e dytë)
	IPV-2 (doza e dytë)	Moshë 5 muajsh (deri në 6 muajsh)	Vaksina pentavalente: DTP-IPV-Hib-3 (doza e tretë)
Moshë 4 muajsh	Vaksina pentavalente: DTP-HepB-Hib-3 (doza e tretë)	Moshë 6 muajsh	HepB-3 (doza e tretë)
	IPV-3 (doza e tretë)	Viti i dytë (mosha 12-15 muajsh)	MMR (doza e parë)
Moshë 12 muajsh	DTPr (rivaksinimi i parë)	Viti i dytë (mosha 18-23 muajsh)	DTPr (rivaksinimi i parë)
	bOPVr (rivaksinimi i parë)		IPVr (rivaksinimi i parë)
	MMR (doza e parë)		

\*Etiketimi i dozave të HepB në kalendarin e imunizimit për fëmijët nga komunitetet serbe në Kosovë si HepB1, HepB2 dhe HepB3 korrespondon me HepB0 (në lindje), HepB1 dhe HepB2 sipas metodologjisë standarde të MICS në rastet kur doza e parë jepet në lindje.

# Pabarazitë në mbulueshmërinë me vaksinim në mesin e fëmijëve të vegjël


## Dallimet socio-ekonomike në mbulueshmërinë me vaksinim

### Imunizimi themelor




Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të cilët kanë marrë të gjitha vaksinat themelore (BCG, Polio3, DTP3, dhe Fruthi 1) në çfarëdo kohë para anketës, sipas gjinisë, vendbanimit, arsimimit të nënës dhe pasurisë së EF

### Imunizimi i plotë




Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të cilët kanë marrë të gjitha vaksinat e planifikuara në dy vitet e para të jetës, sipas kalendarit kombëtar të imunizimit në çfarëdo kohë para anketës, sipas gjinisë, vendbanimit, arsimimit të nënës dhe pasurisë së EF

### Imunizimi themelor



Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të cilët kanë marrë të gjitha vaksinat themelore (BCG, Polio3, DTP3, dhe Fruthi 1) në çfarëdo kohë para anketës, sipas gjinisë, vendbanimit, arsimimit të nënës dhe pasurisë së EF  
( ) Shifrat e bazuara në 25-49 rate të papeshuara

### Imunizimi i plotë




Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të cilët kanë marrë të gjitha vaksinat e planifikuara në dy vitet e para të jetës, sipas kalendarit kombëtar të imunizimit në çfarëdo kohë para anketës, sipas gjinisë, vendbanimit, arsimimit të nënës dhe pasurisë së EF  
( ) Shifrat e bazuara në 25-49 rate të papeshuara

(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflekton pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovën dhe mostrën për MICS me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e pasurisë të llogaritura, pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikun.

## Mbulueshmëria me vaksinim sipas antigjeneve

### Mbulueshmëria me vaksinim në mesin e fëmijëve të vegjël sipas vaksinës specifike

Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 12-23 muajsh dhe 24-35 muajsh të vaksinuar kundër sëmundjeve të parandalueshme në fëmijëri sipas vaksinave specifike në çdarëdo kohe para anketës (Mbulimi i përgjithshëm)

\* Mbulueshmëria me imunizim kundër difterisë, tetanozit dhe kollës (DTP); Treguesi SDG 3.b.1 & 3.8.1

\*\* Doza HepB3 përfshin vetëm fëmijët të vaksinuar sipas kalendarit të imunizimit në Kosovë. Përqindja me imunizim të kompletuar HepB përfshin fëmijë të vaksinuar sipas kalendarit të Kosovës me doza 0, 1, 2 dhe 3 dhe sipas kalendarit serb me doza 0, 1 dhe 2.


\*\*\* Mbulimi i imunizimit të fruthit; Treguesi SDG 3.b.1

## Mbulueshmëria me vaksinim sipas antigjeneve

### Mbulueshmëria me vaksinim në mesin e fëmijëve të vegjël sipas vaksinës specifike

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

■ Fëmijët 24–35 muajsh  
■ Fëmijët 12–23 muajsh



Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muajsh dhe 24–35 muajsh të vaksinuar kundër sëmundjeve të parandalueshme në fëmijëri sipas vaksinave specifike në çdarëdo kohe para anketës (Mbulimi i përgjithshëm)  
Për shënime, shihni grafikoni 'Mbulueshmëria e vaksinimit tek fëmijët e vegjël sipas vaksinave specifike, Kosovë'

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë kryer në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA)

dhe UN Women.

Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS për Kosovën 2019-2020 dhe MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 2019-2020 lidhur me imunizimin. Të dhënat nga kjo pasqyre e shkurtër informative mund të gjenden në tabelat TC.1.1, TC.1.2A dhe TC.1.2B (treguar me shkronjën 'R' për MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë) në Raportin e Gjetjeve të Anketës.

Pasqyrat e shkurtra informative të mëtejshme statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në: [mics.unicef.org/surveys](https://mics.unicef.org/surveys).